


	<p style="text-align: center;"><b>Republika e Kosovës</b>  <b>Republika Kosova –</b>  <b>Republic of Kosovo</b></p> <p style="text-align: center;"><b>Komuna e Prishtinës</b>  Opština Priština –Municipality  of Prishtina</p>	
---	---	---

<b>Datë/a:</b>	16.04.2019
<b>Për/ Za/ To:</b>	N.P.T. “PASHTRIKU”
<b>CC:</b>	Departamenti i Prokurimit
<b>Nga/ Od/ From:</b>	Zekë Bardhaj – Udhëheqës i Departamentit të Prokurimit – Komuna e Prishtinës 
<b>Tema/ Subjekat/Subject:</b>	Vendim për Rishqyrtim të Kërkesës

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Prishtinës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 16.04.2019 të parashtruar nga Operatori Ekonomik “N.P.T. Pashtriku”, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **“Furnizim me material higjienik për Institucionet Arsimore”**, me Nr. të Prok: **616 19 753 121** nxjerr:

## V E N D I M

1. Refuzohet në tërësi si e pa e bazuar kërkesa për rivlerësim e parashtruar nga Operatori Ekonomik “N.P.T. Pashtriku” të dt. 15.04.2019 lidhur me aktivitetin e prokurimit **“Furnizim me material higjienik për Institucionet Arsimore”**, me Nr. **616 19 753 121**, kundër Vendimit të AK –së, të datës **08.04.2019**.
2. Mbetet në fuqi vendimi i AK datë: **08.04.2019**.
3. Autoriteti Kontraktues, vendos që aktivitetin e prokurimit me titull **“Furnizim me material higjienik për Institucionet Arsimore”**, me Nr. **616 19 753 121** të vazhdojë me vendimin e datës **08.04.2019**.
4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

## Arsyetim

Autoriteti Kontraktues – Komuna e Prishtinës me datë 12.02.2019 ka bërë njoftimin për kontratë lidhur me aktivitetin e prokurimiti: **“Furnizim me material higjienik per Institucionet Arsimore”**, me Nr. 616 19 753 12, procedura e hapur.

Hapja e ofertave nga Autoriteti Kontraktues është parapare me datë 27.03.2019. Me datë 08.04.2019, Autoriteti Kontraktues ka ngritur Njoftimin për Vendimin e AK.

OE “N.P.T.Pashtriku”, me dt. 08.04.2019, ka bërë Kërkesë për Rishqyrtim, ne kopje fizike, sipas nenit 108/A të Ligjit për Prokurimin Publik (LPP) lidhur me aktivitetin e prokurimit **Furnizim me material higjienik per Institucionet Arsimore”**, me Nr. 616 19 753 12, kundër vendimit te AK, në të cilin theksohet se AK ka *shkelur dispozitat e LPP, respektivisht:*

Neni 1 i LPP-se: Qëllimi

Neni 7 i LPP-se: Barazia ne trajtim/Jo-Diskriminimi

Neni 38 i LPP-se: Kontrata Publike Kornize

Neni 56 i RUOPP: Kontrata Publike Kornize

Neni 39 i RUOPP: Sqarimi i tenderëve

Neni 59 i LPP- se: Ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve

Neni 41 i RUOPP: Ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve

Neni 72 i LPP-se: Dokumentacioni dhe informacioni shtese

### I. Baza ligjore

Ne lidhje me dispozitat e shkelura te LPP-se për te cilat pretendon OE “N.T.P Pashtriku”, Autoriteti Kontraktues sqaron se ka vepruar ne përputhje te plote me Ligjit për Prokurimin Publik Nr. 04/L-042, dhe njëkohësisht hedhë poshtë te gjitha pretendimet e OE.

#### 1. Edhe pse nuk keni dhëne asnjë argument se si është shkelur:

Neni 1: Qëllimi;

Neni 7: Barazia ne trajtim/Jo-Diskriminimi;

Neni 38 i LPP-se dhe neni 56 i RUOPP “Kontrata Publike Kornize”;

Neni 59 i LPP- se dhe Neni 41 i RUOPP: Ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve

**AK thekson se ka respektuar ne përpikëri këto nen sepse ka shpallur fitues ofertën e përgjegjshme me çmimin me te ulet sepse OE i shpërblyer me kontratë ka përmbushur te gjitha kërkesat e parashtruara ne DT.**

2. **Ne lidhje me pretendimin e shkeljes se Nenit 39 te RUOPP: Sqarimi i tenderëve , AK sqaron se nuk ka vazhduar me verifikim te te dhënave për Kontratën me Komunën e Rahovecit , për arsye se oferta e juaj është e papërgjegjshme për nga ana administrative.**

Sigurimi i i tenderit i dorëzuar nga Ju nuk është dorëzuar ne formën e kërkuar sipas kërkesës se parashtruar ne DT si dhe nuk plotëson kushtet ne përputhje me nenin 39 te RUOPP.

**Kërkesa e parashtruar ne Dosje te tenderit:**

13.4 Forma e sigurisë së tenderit është e specifikuar në Aneksin 4 të kësaj dosje të tenderit.

**Neni 39 i RUOPP**

Problemi	Si te veprohet?	Neni i LPP-se
Sigurimi i tenderit nuk përmban kushtet e përcaktuara sipas formës standarde pjese e DT	Refuzo tenderin pa kërkuar informacion të mëtejshëm	57

Si rrjedhoje, oferta juaj është eliminuar pasi qe nuk është dorëzuar ne përputhje me kërkesën e parashtruar ne DT si dhe, ne përputhje me nenin 39 te RUOPP, nuk përmban kushtet e përcaktuara ne formën standarde te DT, dhe i cili nen decidivisht percakton se nëse mungojnë kushtet e përcaktuara, **AK duhet te refuzoj tenderin pa kërkuar informacion te mëtejshëm.**

**Ju, ne kërkesën për rishqyrtim:**

- ✓ keni deklaruar, se Polisa e sigurimit, e dorëzuar me oferte, i posedon te gjitha te dhënat e Sigurimit te Tenderit. AK, thekson, se Polisa e sigurimit , e dorëzuar me oferte, **NUK i përmban kushtet e përcaktuara** (3 kushtet e përcaktuara ne formën standarde te DT.
- ✓ keni sjelle formën e kërkuar te Sigurimit te tenderit, dhe keni vet-deklaruar se keni menduar qe këtë forme te sjellni nëse oferta e juaj do te propozohet për shpërblim me kontrate. AK, thekson se neni 29.13 i RUOPP përcakton "*Sigurimi i tenderit duhet te dorëzohet i skanuar se bashku me oferte, ndërsa forma origjinale e sigurimit te tenderit do të kërkohet të dorëzohet nga një tenderues të cilin autoriteti kontraktues ka për qëllim qe ta shpërblej me kontratë*", d.m.th. **origjinali kërkohet qe te dorëzohet para shpërblimit e kontratë, e jo forma e re.**

**Provë: Oferta e dorëzuar lidhur me këtë aktivitet**

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar ne ato që u thane më lart ka vendosur si ne dispozitiv.

**Këshilla juridike:**

*Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. Ankesa prane OSHP-se duhet te dorezohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit te ketij vendimi.*

Zyrtari përgjegjës i Prokurimit

